



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljenoi/Prilodato Received/Delivery	11.07.2023	3	viti god year
Organi /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Rr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	5124/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.802/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.802/2023 të datës 01.06.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.802/2023 e datës 01.06.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në pozitën e punës Zyrtar Korrektues në Qendrën e Korrektues ne Lipjan, ne kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 01.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me realizimin e të drejtës së një page jubilarë, me pretendimin ankimor se i njëjti me datën 01.07.2022, ka përmbushur 20 vite përvojë pune ndërsa për shkak të një gabimi në listën e pagave të njëjtit nuk i kanë ekzekutuar kompensimin e një page jubilarë ne shumë prej treqindën e gjashtëdhjetë e pesë euro (365) euro.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave,



me datë 07.07.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të organi i punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 12.06.2023 ka përcjell shkresat lidhur me këtë çështje ankimore

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4566/2023 të regjistruar me numër A.nr.802/2023 të parashtruar nga ankuesi me datën 01.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontratën e Punës të vlefshme nga data 01.07.2002 deri më datën 31.12.2021; Kontratën e punës të datës 30.09.2002; Emalin e datës 074.06.2023 të KPMSHC-së drejtuar KPMSHCK; Emalin e datës 06.06.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 04.06.2023 të drejtuar KPMSHC-së; Emalin e datës 04.06.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Emalin e datës 01.06.2023 të drejtuar KPMSHCK-së; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 07.07.2023; Përgjigjen në ankesë të datës 12.06.2023; Vërtetimin me numër 142 të datës 08.06.2023 të Zëvendës Menaxherit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Listën e Pagave të datës 31.12.2022; Listën e pagave për muajin 31.05.2023; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e punës "Zyrtar Korrektues"; Emalin e datës 05.07.2023 të drejtuar KPMSHC-së; Emalin e datës 05.07.2023 të drejtuar Emalin e datës 07.07.2023 të drejtuar

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit të datës 01.07.2002 është konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar Korrektues në Qendrën Korrektuese në Lipjan në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me datë 01.06.2023 ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për njohjen e të drejtës për kompensimin e një page jubilar, me pretendimin ankimor se i njëjti me datën 01.07.2022, ka përmbushur 20 vite përvojë pune ndërsa për shkak të një gabimi në listën e pagave të njëjtit nuk i kanë ekzekutuar kompensimin e një page jubilar në shumë prej treqindën e gjashtëdhjetë e pesë euro (365) euro.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave bazuar në provat e lëndës respektivisht përgjigjen e datës 05.07.2023 të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës ka konstatuar se ankuesi për njohjen e të drejtës për kompensimin e një page jubilar me rastin e përmbushjes së 20 vite përvojë pune në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk i është drejtuar paraprakisht me kërkesë udhëheqësit me të lartë administrativ si organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje në kuadër të organit të punësimit, kështu që lidhur me këtë objekt të ankesës nuk kemi veprim apo mosveprim nga udhëheqësi me të lartë administrativ në raport me të drejtën e pretenduar në ankesë, për çka ankuesi mund të kontestonte ligjshmërinë e veprimit të organit të punësimit, apo mosveprimin e tij, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht neni 124 ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike*



administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.

Çështja e parashtrimit të ankesës kundër vendimit të organit të punësimit është e përcaktuar edhe me nenin 16 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, meqenëse ankuesit në këtë procedurë nuk kanë parashtruar fillimisht kërkesë të udhëheqësi me i lartë administrativ i cili konsiderohet punëdhënës i ankuesit, Kolegji vlerëson se nuk janë përmbushur kushtet për pranueshmëri të ankesës, siç përcaktohet me nenin 129 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.802/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Shërbimit Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.